- (1) Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 6,300,000 (gjashtë milion e treqind mijë) Lekë, i ndarë në 63,000 (gjashtëdhjetë e tre mijë) aksione të zakonshme, me vlerë nominale 100 (njëqind) Lekë secila, nënshkruar tërësisht nga Aksionari i Vetëm Medsympa Limited, LTD, shoqëri e thelëmuar sipas ligjeve të Republikës së Qipros,

me seli në Akropoleos, Acropolis Tower 66, Nicosia, Strovolos, Republika e Qipros, regjistruar nga Regjistruesi i Shoqërive me numër regjistrimi HE 370134.

Neni 7. Kapitali, Zmadhimi dhe Zvogëlimi

- (1) Kapitali i Shoqërisë ndahet në aksione, dhe çdo aksion i Shoqërisë do të ketë të njëjtën vlerë nominale. Kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën vlerën ligjore minimale, përvèçse kur vlera minimale e kërkuar plotësohet nëpërmjet një zmadhim, i cili vendoset njëkohësisht me zvogëlimin e kapitalit.
- (2) Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë.
- (3) Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet duke emetuar aksione të reja apo duke rritur vlerën nominale të secilit aksion ekzistues.
- (4) Kapitali i Shoqërisë nuk mund të zmadhohet, nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkruara më parë.
- (5) Zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet duke anuluar aksione apo duke ulur vlerën nominale të secilit aksion.
- (6) Nëse zvogëlimi i kapitalit nuk justifikohet nga mbulimi i humbjeve të Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të anulojë një ose shumë aksione sipas dispozitive të parashikuara nga Neni 12, si dhe duke respektuar kërkuesat e Ligjit Tregtar.
- (7) Shoqëria publikon në Regjistrin Tregtar, vendimin e zmadhimit apo të zvogëlimit të kapitalit, në përputhje me afatet e kërkua nga ligji.
- (8) Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit konsiderohet i realizuar vetëm pas regjistrimit të realizimit në Regjistrin Tregtar. Zmadhimi i kapitalit nuk mund të quhet i realizuar përpërfundimit të afatit të nënshkrimit të siç përcaktohet nga Neni 8, dhe realizimi lidhet vetëm me pjesën e shumave të rritura që janë nënshkruar efektivisht.
- (9) Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit i nënshtronhet gjithashtu parashikimeve të detyrueshme të Ligjit Tregtar, si dhe parashikimeve të tjera të ligjit për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit në raste të veçanta, që nuk rregullohen posaçërisht nga ky Statut.

Neni 8. Aksionet, Kontributet

- (1) Me përashtim të rastit kur Shoqëria emeton aksione të kategorive të ndryshme (aksione të zakonshme, me përparësi, me ose pa të drejtë vote), aksionet e shoqërisë do të janë të zakonshme, dhe çdo aksion i zakonshëm do të japë të njëjtat të drejta.
- (2) Nëse Shoqëria emeton aksione të kategorive të ndryshme, të drejtat dhe përparësise që burojnë nga aksionet e kategorive të veçanta vendosen nga Asambleja e Përgjithshme, me të njëjtën shumicë të kërkuar për ndryshimin e Statutit. Këto vendime do të përbëjnë pjesë të këtij Statuti, dhe të drejtat dhe përparësitë e shënuara në Statut do të konsiderohen shteruese.
- (3) Kriteret e vlerësimit dhe procedurat për shndërrimin e aksioneve nga një kategorie në tjetrën, si dhe për shndërrimin e obligacioneve e titujve të tjerë në aksione, vendosen nga Asambleja e Përgjithshme, me të njëjtën shumicë të kërkuar për ndryshimin e Statutit.
- (4) Nënshkrimi i aksioneve të reja duhet të kryhet brenda afatit të përcaktuar nga vendimi i Asamblesë së Përgjithshme që vendos një rritje.

- (5) Secili aksionar ekzistues, proporcionalisht me numrin total të aksioneve të zotëruara, do të ketë të drejtën të nënshkruajnë aksionet e reja, duke u preferuar ndaj çdo personi të tretë, me kusht që e kjo e drejtë të ushtrohet brenda afatit të percaktuar sipas Pikës (4) të këtij Neni. Kjo drejtë parablerje mund të kufizohet në bazë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme sipas Ligjit Tregtar.
- (6) Aksionet e nënshkruara me kontribut në para duhet të shlyhen, të paktën në një të katërtën e vlerës së tyre nominale, sipas rastit, përpara regjistrimit të Shoqërisë apo regjistrimit të realizimit të zmadhimit të kapitalit. Shumat e nënshkruara që mbeten, shlyhen në një ose më shumë këste, sipas njoftimit për shlyerje nga ana e Këshillit të Administrimit, në përputhje me aktin e emetimit të aksioneve. Primet mbi aksionet e nënshkruara me kontribut në para duhet të shlyhen tërësisht përparrë regjistrimit të realizimit të zmadhimit te kapitalit.
- (7) Aksionari që nuk shlyen pjesën e mbetur të shumave të nënshkruara, brenda afatit të njoftimit për shlyerje nga ana e Këshillit të Administrimit, detyrohet t'i paguajë Shoqërisë kamatëvonesat sipas Ligjit Tregtar.
- (8) Nëse pjesa e mbetur të shumave të nënshkruara mbetet e papaguar pas 30 ditësh nga përfundimi i afatit të percaktuar sipas njoftimit të Këshillit të Administrimit, të drejtat të votës, si dhe çdo e drejtë tjetër e lidhur me aksionin e pashlyer do të pezullohet automatikisht, dhe aksioni i pashlyer nuk do të merret parasysh në llogaritjet përritjen e kuorimit në Asamblenë e Aksionarëve.
- (9) Nëse aksioni mbetet i pashlyer pas 90 ditësh nga përfundimi i afatit të percaktuar sipas njoftimit, atëherë Këshilli i Administrimit mund t'ia ofrojë aksionin ofertuesit më vlerë më të lartë, dhe nëse nuk ka asnjë ofertë me vlerë të paktën sa vlera nominale e aksionit, të anulojë atë, siç parashikohet nga Neni 12.
- (10) Në rastet e anulimit të aksionit siç parashikohet nga Pika (9) e këtij Neni, çdo shumë e para-paguar në lidhje me këtë aksion mbahet nga Shoqëria për të mbuluar dëmin e pësuar, pa cenuar këtu të drejtën e Shoqërisë për të kërkuar dëmin e mëtejshëm, nëse ka, nga personi që ka nënshkruar aksionin e pashlyer.
- (11) Personi që ka nënshkruar aksionin e pashlyer është përgjegjës për shlyerjen e shumave të nënshkruara në mënyrë solidare me personin të cilin i ka/është kaluar aksioni i pashlyer, pavarësisht nëse aksioni është kaluar përparrë apo pas kërkësës për shlyerje.
- (12) Aksionet e nënshkruara me kontribut në natyrë duhet të shlyhen tërësisht, nëpërmjet kalimit të titullit të pronësisë këtij kontributi në favor të Shoqërisë, përparrë regjistrimit të realizimit të zmadhimit të kapitalit. Vlerësimi i kontributeve në natyrë do të kryhet nga vlerësues të pavarur, në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

Neni 9. Akti i Emetimit të Aksioneve

- (1) Aksionet e nënshkruara do të emetohen nëpërmjet aktit të emetimit të aksioneve, që miratohet Këshilli i Administrimit të Shoqërisë, pa vonesa, sipas rastit, pas regjistrimit të Shoqërisë, apo pas regjistrimit të realizimit të zmadhimit të kapitalit. Aksionet dhe të drejtat e lidhura me to nuk mund të transferohen përparrë miratimit të aktit të emetimit të tyre.
- (2) Akti i emetimit të aksioneve përbanë të paktën të dhënat vijuese:
- Emrin dhe adresën e selisë të Shoqërisë;
 - Numrin dhe datën e vendimit për zmadhimin e kapitalit;
 - Datën kur zmadhimi i kapitalit është bërë efektiv nëpërmjet regjistrimit të realizimit në Regjistrin Tregtar;
 - Vlerën totale të emetimit (vlerën totale të zmadhimit të kapitalit që është

- e) nënshkruar e realizuar);
- f) Vlerën totale dhe për aksion të primeve të emetimit, nëse ka;
- g) Klasën e aksioneve të emetuar dhe të drejtat që u jepen aksionarëve (përparësitë);
- h) Numrin total të aksioneve të emetuara;
- i) Shumën totale të shlyer përpara emetimit;
- j) Përqindjen totale të shlyer përpara emetimit;
- k) Qëllimin e përdorimit të fondeve;
- l) Afatet e shlyerjes së pjesës së mbetur të vlerës nominale të aksionit;
- m) Përqindjen që zë emetimi i aksioneve në kapitalin total pas emetimit;
- n) Mundësitet e konvertimit në klasa të ndryshme aksionesh, nëse ka;
- (3) Akitit të emetimit të aksioneve i bashkëngjitet lista e plotë e personave që kanë nënshkruar aksionet.

Neni 10. Aksionarët, Regjistri i Aksioneve

- (1) Aksionarët e Shoqërisë do të janë personat të cilët kanë fituar aksionet e tyre në mënyrat e përcaktuara nga Ligji Tregtar dhe dispozitat e këtij Statuti.
- (2) Aksionarët e Shoqërisë do të regjistrohen një regjistër të posaçem (në vijim “**Regjistri i Aksioneve**”), i cili do të hartohet nga Këshilli i Administrimit menjëherë pas miratimit të akitit të parë të emetimit të aksioneve. Regjistri i Aksioneve përmban të dhënat përcaktuara sipas Ligjit Tregtar në lidhje me të gjitha aksionet e Shoqërisë.
- (3) Këshilli i Administrimit, sipas rastit, përditëson Regjistrin e Aksioneve me të dhënat përkatëse të lidhura me ndryshimet në aksionet e Shoqërisë, në përputhje me këtë Statut dhe me parashikimet e Ligjit Tregtar.
- (4) Personat e regjistruar në Regjistrin e Aksioneve prezumohen si aksionarë të Shoqërisë me të drejta të plota si për marrëdhëniet me Shoqërinë, ashtu dhe ndaj të tretëve.
- (5) Aksionet e të drejtat e fituara mbi to, nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj Shoqërisë, përpara se veprimi i transferimit të jetë regjistruar në Regjistrin Aksioneve që mban Shoqëria.
- (6) Shoqëria depoziton një kopje të përditësuar të Regjistrat të Aksioneve pranë Regjistrat Tregtar, sipas afateve të parashikuara nga ligji.

Neni 11. Blerja e Aksioneve të Veta

- (1) Shoqëria nuk mund të nënshkruajë aksionet e veta.
- (2) Shoqëria mund të blejë aksionet e veta nga persona që i kanë nënshkruar ato më parë, me kusht që brenda 1 viti nga data e blerjes, këto aksione t'i shiten një aksionari apo një pale të tretë, apo të anulohen, siç parashikohet nga Neni 12, dhe të çregjistrohen nga Regjistri i Aksioneve.
- (3) Gjatë periudhës që Shoqëria zotëron aksionet e veta, të drejtat të votës, si dhe çdo e drejtë tjetër e lidhur me këto aksione do të pezullohet automatikisht, dhe këto aksione nuk do të nuk do të merret parasysh në llogaritjet për arritjen e kuorumi të Asamblenë e Aksionarëve.

Neni 12. Anulimi i Aksioneve

- (1) Aksionet e Shoqërisë mund të anulohen me vendim të Këshillit të Administrimit, vetëm në rastet vijuese:

- a) Nëse personi që ka nënshkruar aksionin, nuk shlyen kontributin në para, siç përcaktohet nga Neni 8. Pika (9); ose
 - b) Nëse Shoqëria nuk ka rishitur aksionet e saj, siç parashikohet nga Neni 11; ose
 - c) Nëse aksionari që i zoteron ato, pranon anulimin e aksioneve;
- (2) Vendimi i Këshillit të Administrimit mbi anulimin e aksioneve do të ketë pasojë zvogëlimin e kapitalit me vlerën përkatëse nominale të aksioneve të anuluara, duke zëvendësuar vendimin e Asamblesë së Përgjithshme për zvogëlimin e kapitalit.
- (3) Në rastet e parashikuara sipas gërmave a) dhe b) të Pikës (1) të këtij Neni, shoqëria nuk paguan asnje kompensim, ndërsa përrastin e anulimit sipas gërmës c), Shoqëria shpërblen aksionarin përkatës sipas kushteve të rëna dakord, dhe miratuar nga vendimi i Asamblesë së Përgjithshme.
- (4) Çdo aksioni i shoqërisë, i cili anulohet sipas këtij nenit, do të çregjistrohet nga regjistri i aksioneve, dhe Shoqëria do t'i njoftojë Regjistrat Tregtar anulimin e aksionit dhe zvogëlimin përkatës të kapitalit.

Neni 13. Kalimi i Aksioneve

- (1) Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen lirisht sipas parashikimeve të Ligjit Tregtar dhe duke respektuar kushtet e përbajtura në këtë Statut.
- (2) Nëse një prej aksionarëve të Shoqërisë do të transferojë një a më shumë aksione në favor të një aksionari tepër apo të një pësoni të tretë, atëherë ai është i detyruar të njoftojë me shkrim Këshillin e Administrimit, duke e njoftuar të paktën mbi numrin e aksioneve që do të transferohen, datën kur transferimi hyn në fuqi, si dhe identitetin dhe adresën e personit që do të fitojë aksionet. Ky njoftimi duhet të shoqërohet me një kopje të dokumenteve të transferimit, si dhe, nëse personi që fiton aksionet, nuk është aksionar i Shoqërisë, me kopje të dokumentit personal të identifikimit, ose të dokumenteve të duhura të identifikimit regjistrimit, nëse person juridik.
- (3) Këshilli i Administrimit nuk është i detyruar të shënojë emrin e personit që fiton aksionet, në Regjistrin e Aksioneve, nëse njoftimet dhe dokumentet e mësipërme nuk paraqiten rregullisht nga aksionari që transferon aksionet.

Neni 14. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Mbledhja e Asambleja e Përgjithshme thirret përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar, nga Këshilli i Administrimit, po në rast urgjencë, nga çdo anëtar Këshillit apo nga çdo Administrator. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret edhe nga personat e tjera të përcaktuar sipas Ligjit Tregtar.
- (2) Mbledhja e Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë gjate një viti finanziar për miratimin e bilancit vjetor, dhe sa herë që konsiderohet e arsyeshme përmbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë. Gjithashtu, thirrja e Asamblesë së Përgjithshme bëhet sa herë kjo është e detyrueshme sipas Ligjit Tregtar.
- (3) Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të njoftohet të paktën 21 (njëzetë e një) ditë përpëra datës së mbledhjes. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të kryhet sipas kërkesave të Ligjit Tregtar dhe të këtij Statuti, dhe të përbajë të dhënat dhe informacionin e kërkuar sipas këtyre akteve.
- (4) Aksionarët nuk mund të kërkojnë shpalljen e pavlefshmërisë së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme për shkak të mungesës së njoftimit, nëse aksionari i ka dhënë Shoqërisë një adresë të pasaktë për regjistrim pranë Regjistrat Tregtar i aksioneve, apo nuk i ka njoftuar Këshillit të Administrimit ndryshimin e adresës përpëra nisjes së njoftimit.

Neni 15. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme do të marrin pjesë vetëm aksionarët e regjistruar në Regjistrin e Aksioneve të Shoqërisë. Aksionarët mund të marrin pjesë në mbledhje personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar.
- (2) Një aksionar mund të autorizojë aksionarë të tjera apo palë të treta, por jo Administratorët apo anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë, për ta përfaqësuar atë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Autorizimi duhet të jetë me shkrim, dhe të përfshijë vetëm një mbledhje, si dhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. Një aksionar nuk mund të autorizojë persona të ndryshëm për ta përfaqësuar atë në lidhje me pjesë të aksioneve të zotëruara prej tij.
- (3) Autorizimi i përfaqësimit duhet të depozitohet në selinë e Shoqërisë, në original apo në kopje të njësuar, jo më vonë se afati, përpara mbledhjes së Asamblesë se Përgjithshme, përcaktuar në njofimin e thirrjes. Asnjë person nuk do te lejohet të përfaqësoj një aksionar në mbledhjen e Asamblesë nëse autorizimi është depozituar mbas këtij afati.
- (4) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të kryesohet nga Kryetari i Këshillit të Administrimit, apo në mungesë nga anëtarët që jetojnë më i vjetër në moshë i Këshillit të Administrimit. Në mungesë të tyre, mbledhja do të kryesohet nga personi i caktuar prej shumicës së aksionarëve të pranishëm.
- (5) Kryesuesi i mbledhjes do të caktojë një person si mbajtës të procesverbalit, dhe do të hartojë listën e pjesëmarrësve, duke verifikuar identitetin e tyre dhe/ose tagrat e përfaqësimit, si dhe numrin e aksioneve dhe të drejtat e votave që zotërohen nga aksionaret e pranishëm apo të përfaqësuar.
- (6) Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratorët e Shoqërisë kanë të drejtën të marrin pjesë në çdo kohë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.
- (7) Asambleja e Përgjithshme nuk mund të kryejë punime e të marrë asnjë vendim nëse një numër aksionarësh të regjistruar në Regjistrin e Aksioneve, që zotërojnë të paktën 30% të aksioneve, me të drejtë vote, nuk janë të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhje.
- (8) Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e mbledhjeve të saj, përfshi këtu thirrjen, pjesëmarrjen dhe votimin me mjete elektronike.

Të Drejtat e Votës, Vendimtarja e Asamblesë

- (1) Në varësi të të drejtave ose kufizimeve që lidhen me aksionet, secili aksion i zakonshëm mbart të drejtën e 1 (një) votë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Të drejtat e votës mund të kufizohen në rastet e parashikuara nga Ligji Tregtar dhe ky Statut.
- (2) Aksionari që zotëron më shumë se një aksion detyrohet të votojnë në mënyrë uniforme për të gjitha aksionet e zotëruara prej tij, dhe nuk mund të ushtrojë të drejta vote me kahe të ndryshme për secilin aksion të zotëruar.
- (3) Asamblesë së Përgjithshme ka kompetencë për të miratuar vendime detyruese për çështjet e përcaktuara sipas Ligjit Tregtar dhe këtij Statuti.
- (4) Vendimet në lidhje me çështjet vijuese të Asamblesë së Përgjithshme merren me tre të katërtat e votave të aksionarëve pjesëmarrës (ose të përfaqësuar) me të drejtë vote:
 - a) ndryshimi i këtij Statutit;

- b) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
 - c) shpërndarja e fitimeve;
 - d) riorganizimin dhe prishja e Shoqërisë;
 - e) çështje të tjera që sipas Ligjit Tregtar apo këtij Statuti kërkojnë të njëjtën shumicë
- (5) Përveç rastit kur Ligji Tregtar apo ky Statut kërkon një shumicë më të lartë, të gjitha vendimet e tjera të Asamblesë së Përgjithshme merren shumicën e votave të aksionarëve pjesëmarrës (ose të përfaqësuar) me të drejtë vote. Në rastet kur kërkohet nga Ligji Tregtar, vendimet i nënshtrohen gjithashtu miratimeve të posaçme nga aksionarë të veçantë / të grupeve të veçanta.
- (6) Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes. Prosesverbalit përban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryesuesit dhe të mbajtësit të procesverbalit, mënyrën e mbajtjes së mbledhjes dhe të votimit, një përbledhje të diskutimeve kryesore, rezultatet e votimit, si dhe çështjet e tjera që duhet të shënohen në të sipas Ligjit Tregtar apo rregulloreve të Asamblesë se Përgjithshme.
- (7) Këshilli i Administrimit përgjigjet për ruajtjen e procesverbaleve dhe dokumenteve të tjera të lidhura me mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Kur procesverbalit përban të dhëna konfidenciale për aktivitetin e Shoqërisë, mund të nxjerrin ekstrakte të pjesëve të veçanta.
- (8) Këshilli i Administrimit, i vë në dispozicion kopje të procesverbalit aksionarëve që e kërkojnë, sa më shpejt të jetë e mundur, po në çdo rast jo më vonë se afati i përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 17. Aksionari i Vetëm

- (1) Nëse Shoqëria zotërohet nga një aksionar të vetëm, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë se Përgjithshme do të ushtrohen nga Aksionari i Vetëm.
- (2) Të gjitha vendimet e marra në këtë cilësi do të mbahen në një regjistër vendimesh, data e të cilave nuk mund të korrigohet ndryshohet apo fshihet.
- (3) Çdo vendim që nuk regjistrohet në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet i pavlefshëm dhe pa pasoja ligjore.

Neni 18. Këshilli i Administrimit

- (1) Shoqëria do të administrohet sipas sistemit me një nivel, nga një Këshill Administrimi i përbërë nga një numër tek anëtarësh, nga 3 (tre) deri në 21 (njëzetë e një) anëtarë, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.
- (2) Anëtarët e Këshillit të Administrimit janë individë të caktuar nga Asambleja e Përgjithshme për një afat jo më të gjatë se tre vite, me mundësi ri-emërimi. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Anëtarët e Këshilli i Administrimit në çdo kohë.
- (3) Shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit përbëhet nga anëtarë të pavarur, jo ekzekutiv, të ndryshëm nga duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga Administratorët e shoqërisë. Ndaj anëtarëve të Këshillit të Administrimit zbatohen kufizimet e zgjedhshmërisë, parashikuar sipas Ligjit Tregtar.
- (4) Këshilli i Administrimit gjëzon të drejtat dhe detyrimet që përcaktohen sipas Ligjit Tregtar dhe sipas këtij Statuti.
- (5) Anëtarësia në Këshillin e Administrimit është personale dhe një anëtar nuk mund t'i delegojë një personi tjetër të drejtat e detyrimet e tij në këtë cilësi.

- (6) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe sipas këtij Statuti apo rregulloreve të funksionimit të Këshillit të Administrimit, mbledhjet e Këshillit të Administrimit mbahen rregullisht me praninë e shumicës së anëtarëve të emëruar, dhe Këshilli i Administrimit merr vendime me shumicën e anëtarëve të pranishëm.
- (7) Anëtarët e Këshillit te Administrimit zgjedhin mës tyre Kryetarin dhe Zëvendës Kryetarin, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të emëruar.
- (8) Këshilli i Administrimit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të emëruar, mund të miratojë rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e tij, përfshi këtu formalitetet e thirrjes së mbledhjeve, pjesëmarrjen dhe votimin me mjete elektronike.

Neni 19. Administratorët

- (1) Këshilli i Administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të Shoqërisë, për një afat jo më të gjatë se 3 vjet, me të drejtë ri-emërimi. Këshilli i Administrimit mund të shkarkojë Administratorët në çdo kohë.
- (2) Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të kryejnë detyrën e Administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit që nuk e kryejnë këtë detyrë.
- (3) Administratorët gjëzojnë të drejtat dhe detyrimet që përcaktohen sipas Ligjit Tregtar.
- (4) Administratorët janë përfaqësuesit ligjor të Shoqërisë, dhe kanë të drejtë të përfaqësojnë Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet, brenda kufizimeve të tagrave të përfaqësimit që mund të caktohen nga Këshilli i Administrimit.
- (5) Këshilli i Administrimit mund të vendosë kufizime në lidhje me tagrat e përfaqësimit të Administratorëve për të vepruar të vetëm në lidhje me disa, apo me të gjitha marrëdhëniet e Shoqërisë me të tretët, duke parashikuar nënshkrimin e dyfishtë me një Administrator apo anëtar tjetër të Këshillit të Administrimit.
- (6) Tagrat e përfaqësimit të Administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen pranë Regjistrat Tregtar në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.

Neni 20. Shpërblimi

- (1) Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratorët përfitojnë shpërblimet sipas skemës së shpërblimeve të përgatitur nga Këshilli i Administrimit dhe miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.
- (2) Shpërblimet e anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe i Administratoreve, do të jenë në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

Neni 21. Dividendët

- (1) Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të shpérndajë dividend në favor të aksionarëve në përputhje me parashikimet e këtij Statuti dhe të Ligjit Tregtar.
- (2) Dividendi paguhet në një ose disa këste, duke pasur parasysh nevojat e likuiditetit të Shoqërisë, me kush që Shoqëria të këtë përbushur kërkesat e rezervës ligjore sipas Ligjit Tregtar.
- (3) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme që miraton zmadhimin, aksionet e emetuara rishtazi marrin pjesë në fitimet e të gjithë vitit finanziar, gjatë të cilit ato janë emetuar.

Neni 22. Rezervat

- (1) Asambleja e Përgjithshme krijon rezerva sipas përcaktimeve të Ligjit Tregtar. Me propozim të Këshillit të Administrimit, Asambleja e Përgjithshme, me shumicën e nevojshme për ndryshimin e këtij Statuti, mund të miratojë krijimin e rezervave të tjera posaçme nga fitimet e aktivitetit të Shoqërisë.

Neni 23. Prishja dhe Likuidimi

- (1) Shoqëria prishet në rastet e parashikuara nga Ligji Tregtar. Prishja e Shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë shkaqe për nisjen e procedurave të falimentimit.
- (2) Likuidimi i Shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e pjesës përkatëse të Ligjit Tregtar.

Neni 24. Të Ndryshme

- (1) Ky Statut nënshkruhet në gjuhën Angleze, me një përkthim në gjuhën Shqipe. Në rast mospërputhjesh, versioni në gjuhën Angleze do të mbizoteroje.
- (2) Ky Statut do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje më legjisacionin e Republikës së Shqipërisë. Për sa nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat e Ligjit Tregtar.

Neni 25. Emërimi i Organeve të Para të Shoqërisë

- (1) Administratorët dhe Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë emërohen personat e listuar në Aneksin 2) bashkëlidhur.
- (2) Auditor(ët) e parë të Shoqërisë emërohen personat e listuar në Aneksin 3) bashkëlidhur.

**MIRATUAR NGA
THEMELUESI DHE AKSIONARI I VETËM
MEDSYMPAN LIMITED, LTD**

Përfaqësuar nga

Ekaterini Kaishari
Drejtore

Alexis Christephides
Drejtore

Nicosia, Qipro, 02.10.2018

Nënshkruar (ose vulosur) sot në prezencën time nga **Ekaterini Kaishari**, **Alexis Christephides** Si Nëpunës Vërtetues, Unë vërtetoj vetëm nënshkrimin që shfaqet në dokument dhe nuk mbaj përgjegjësi për përbajtjen e këtij dokumenti. Në dëshmi të kësaj unë vendos nënshkrimin tim dhe vulen zyrtare sot më datë 2 tetor 2018

[nënshkrim]

CHRISTINA D. ARGYROU
Nëpunës Vërtetues

[vula]

Kjo është për të vërtetuar se nënshkrimi i shfaqur më sipërështë nënshkrimi i **Z. Christina D. Argyrou**, Nëpunës Vërtetues i Nicosia i caktuar nga Ministria e Brendshme e Republikës së Qipros në bazë të Ligjit 155(1)2012 të Nëpunësit Vërtetues për të vërtetuar nënshkrimet dhe vulat dhe se vula përkundrejt nënshkrimit në fjalë është e Nëpunësit Vërtetues të Nicosia. Nëpunësi i Rrethit vërteton vetëm nënshkrimin dhe vulen e Nëpunësit Vërtetues dhe nuk mban përgjegjësi për përbajtjen e këtij dokumenti.
Nicosia - Qipro

[nënshkrim]
për Nëpunësin e Rrethit Nicosia
O. ASPRAKI

.....
04 TETOR 2018

**Apostille**

(Konventa de la Haye du 5 octobre 1961)

1. Shteti; QIPRO
Ky dokument publik
2. është nënshkruar nga O. ASPRAKI
3. duke vepruar në cilësinë e Nëpunësit të Rrethit
4. mbajtes i vulës/pullës së Nëpunësit të Rrethit

Vertetuar

5. në Nicosia
6. më 04 TETOR 2018
7. nga CHRYSI BLISTA
8. Nic MJPO Nr. 207037/18
9. Vula/Pulla

10. Nënshkrimi
Për/Sekretari i Përherershëm
Ministria e Dretësisë dhe e Rendit Publik

ANEKSI 1)
(Anëtarët e Parë të Këshillit të Administrimit)

Erik Solon Mano		Sarantis Dimitriou	Prodromos Tatsoglou
Afati i Emërimit	3 vjet nga data e themelimit	3 vjet nga data e themelimit	3 vjet nga data e themelimit
Datëlindja	10/11/1966	20/07/1971	23/01/1974
Vendlindja	Ëashington DC	Athinë	Selanik
Nënshtetësia	Greke	Greke	Greke
Dokumenti i Identifikimit	Pasaportë nr. AN08900153	Pasaportë nr. AN3321998	Pasaportë nr. AN0552869
Adresa	20 km N. Road Kalohoriu - Thessalonikis 54628 Selanik, Greqi	2A Irodot Attikou str., 15124 Maroussi Athinë, Greqi	20 km N. Road Kalohoriu - Thessalonikis 54628 Selanik, Greqi

(Administratörët e Parë)

Ilias Papadimitriou		Prodromos Tatsoglou
Afati i Emërimit	3 vjet nga data e themelimit	3 vjet nga data e themelimit
Kufizime të tagrave	Nuk ka	Nuk ka
Datëlindja	26/11/1962	23/01/1974
Vendlindja	Athinë	Selanik
Nënshtetësia	Greke	Greke
Dokumenti i Identifikimit	Pasaportë nr. AM0773982	Pasaportë nr. AN0552869
Adresa	12A Irodot Attikou str., 15124 Maroussi Athinë, Greqi	20 km N. Road Kalohoriu - Thessalonikis 54628 Selanik, Greqi



ANEKSI 2)
(Auditorët e Parë)

Emri	Adresa	Autoriteti Licencues	Nr./Data e Licencës
Deloitte Audit Albania sh.p.k	Rr. Elbasanit, Pallati Poshtë F. Gjeologji Miniera, Tiranë, 1001, Shqipëri	IEKA	423/31.07.2014




Përkthiri:
Magjilida Shestu
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 8637 Rep.

Tirane, me 31.10.2018

V E R T E T I M

Vërtetohet firma e perkthyeses se gjuhes Angleze Znj. Majlinda Sheshi, e njohur prej meje, e cila deklaroit se perktheu dokumentin bashkangjitur ne mënyre autentike nga gjuha Angleze ne gjuhen Shqipe, dhe nënshkroi rregullisht sipas ligjit.



NOTERI

JULIAN ZHELEGU